PARKALESI

BKSI

ВКSH

BKSH

BKSH

PARKALESI PER TE VDEKURITE

BKSH

BKSH

PARKALESI PËR TË VDEKURITË

Bekuar kloftë i madh'in'Zot për herë nani e gjithë monë e për jetë të jetëvet. Amin.

O i Shejti Perëndi, i Shejt i fukjishëm, i Shejt i pavdekshim, Lipisi për ne. (tri here).

Lëvdi pastë Ati, Biri, Shpirti Shejt nani e gjithë monë e për jetë të jetëvet. Amin.

Trini gjithë e shejte, paçe lipisi për ne; o Zot ijna afër te mëkatëtë t'ona; o i Zot, na ndëje fajëtë t'anë. Eja, o i Shejt, e na shëndosh ligështin t'ëne paj të emërit t'it.

Lipisi, lipisi, o Zot, paçe lipisi. Lëvdi past... Ati jine...

Pse jotia është rregjëria e pushtetia e lëvdia e t'Jatit e të Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithë monë e për jetë të jetëvet. Amin.

Tropariet

O Ti çë me të thellë urtësi për njerëzit gjith-kjish zotëron, * e nga njeriu i jep atë çë i vlen, o i vetmi Stisor, * prëj, o i Madh'in'Zot, shpirtërat e shërbëtorevet t'atë; * se tek Ti vun ata shpresën e' tireve, tek Ti Beresi e Krijuesi e Perendia jine.

Bashk me Sheitërat prëj, o Krisht, * shpirtërat e shërbëtorëvet t'atë, * te ku ng'isht helm, * jo lip, * jo psherëtim, * po gjellë e pasosme.

Tij për mburonjë e pështrim na kemi, * e fiala jote isht e priturë mirë * nga Perëndia cë ngak Ti leu, * o Mëma e Perëndis e pa-nusërte, shpëtimi i të besmëvet.

I - (Makarii i Amomi en odho...)

Të lumë te dërejtitë për në dhrom. Alliluja.

I bekuarë je, o Zot, mësomë ti të dërejtatë t'ote. Alliluja.

Shpirti jim ka dishiruar me mall gjikimet t'atë kurdoherë. Alliluja.

Shpirti jim kle kjëlluar nga hidhërimi; jipmë Ti, fukji o Zot, mbas fialës. Alliluja.

Uj zëmërën t'ime te dishirimet t'ate e jo në lakmi. Alliluja.

U i trembem fort të mëkatruamëvet çë harruan ligjën t'ënde. Alliluja.

U jam një nga ata çë të trëmben e ruajën urdhurimet t'ate. Alliluja.

Lëvdi past... mani... Alliluja.

II - (E hjires su...)

Duartë t'ote më bën e më gjeshën; ëm ndelgim dhe urdhurimet t'atë dot mësonjë. Kij lipisi për shërbëtorët t'atë.

Pse u bëra posi luleja në brimë; po ngë harrova urdhurimet t'atë.

Jiti jam u; shpëtomë ti, se vetëm të dërejtat t'ote kam kërkuar.

Jashta gjikimevet t'atë ngë kam dalë u; pse mua Ti më ke mësuar.

Vëra zëmbrën t'ime të ruaja urdhurimet t'atë për gjithëmonë si shpërblim.

Hera isht, o Zot, per Tij, te vepëroshë; pse ata kane shkelurë ligjën t'ënde. Kij lipisi për shërbëtoret t'atë e për mua. Alliluja.

III - (Epivlepson...)

Ti mbaj siun t'ënt mbi mua e kijëmë lipisi mbas gjikimit t'atireve çë duan mirë emërin t'ënt. Alliluja.

I vogël jam u e i pavëjefshim, po ngë harronj të dërejtat t'ote.

Mirr 'vesh zërin t'im mbas lipisis s'ate e mbas gjikimit t'ënt ëm gjellë, o Zot.

Të parët më kanë përzënë pa pasur likjë; po zëmbra jime në poni ka mbaitur gjithëmonë fialën t'ënde.

Shpirti jim kat rronje, e ka të t' lëvdonjë, gjikimet t'atë ka t'më ndihiën.

U kam vatur tue rrahur si dele e sbierrë. Kërke Ti shërbëtorin t'ënt, pse u ngë harronj urdhurimet t'atë.

Evlojitaria

I bekuarë je, o Zot, mësomë Ti të dërejtatë t'ote.

Shokjëria e Shejtëravet * gjeti bu-

rimin e gjellës * edhe derën e Parraisit; gjetsha edhe u * dhromin me pendimin; * deleja * e sbierrë u jam; * thirrëmë, o Shelbues, e shpëtomë.

I bekuarë.....

O ju çë kjenkjin * e Perëndis ligjiruatë, * e çë kletë therturë si kjenkje * e çë te gjella e pamblakëshme e pasosme * o Shejtëra kletë kallurë, * Atij pa u lodhure, * o Martëra, ju të lutij * te na ndëjenjë detirët t'ona.

I bekuarë.....

O ju gjithë * çë muarët dhromin e ngusht * e plot-mjerime te jeta; * e çë krikjen si dsigua e nglakuatë, * e prapa meje jerdhet me besë, * ejani të trashgoni * ata shpërblime e kurorët * çë ju taksa në kjiell.

I bekuarë.....

Fitira u jam * të lëvdis s'ate të parrëfieshme, edhe në kam dserkjet e ftesavet; kij lipisi * për të bëmën t'ende, o Zot, e pastroje me dhëmbësirën t'ënde * e ëm athdeun të dishiruam * e te Parraisi bëjmë pameta të vinjë.

I bekuarë.....

Ti çë më gjeshe çë moti nga mos të klënitë * e me fitirën t'ënde të perëndishme më nderove, * e se shkela urdhurimin, përapë te dheu më prore ngaha kleva marrë * bën Ti të të glas pameta * e të marrë bukurin e motshme.

I bekuarë.....

Prëhi * shërbëtorët t'atë, o Perëndi, e vëri në Parrais * ku shokjëritë * e shejtëravet, o Zot, e të dërejtitë * llambarisiën si dritarë; * prëj shërbëtorët të ndëjemitë * e mos vërrej gjithë kekjëbëmat e 'tire.

Lëvdi pastë.....

Të trishkëlkjeritë e të vetmes Hjyini * let imnojëm tue thirrur: Shejt je Ti, * o Ati i pa-zënë fill, * o Biri bashkë i pa fillim e Shpirt i hjyinushëm; * ndritëso neve, * çë me besë të falemi prëmist, * nga ziarri i përjetëshëm shpëtona.

Nani.....

T' falemi, o e nderëshme * se Perëndin njeri leve * per shpëtimin të të gjithëve, * se per Tij njerëzia * gjeti shpëtimin; * për Tij gjetshim na Par-

raisin, o Mëma e Perëndis e bekuame dhe e kulluame.

Alliluja (3) Lëvdi Tij, o Perëndi.

Thrinò ...

Klanj e vajtonj kur mendonj vdekjien e shoh bukurin t'ënë, e bërë mbas fitirës së Perëndis, shtruarë te varret e shfitiruarë, e palëvdishme, pa dukie. Oh, çë famasmë! Çë isht ki mister rreth nesh? Si klemë përdhënë prishies?

Si klemë bashkuarë vdekjies? Vërteta, si isht shkruarë, gjithëkjish vijën mbas urdhurimit të Perëndis çë dhuron prëhien atireve çë ndërruanë jetë.

LUMERITE

Të rregjëria jote kujtou për ne, o Zot. Kujtou për ne kur vien te rregjëria jote.

Të lumë të vapkjitë në shpirt, se e 'tiria isht rregjëria e kjielliavet.

Të lumë ata çë klanë, se ata ka t' ʃenë ngushulluarë.

Të lumë te butitë, se ata ka t'trashgojën jetën.

Të lumë ata çë kanë uri e etë ligjie, se ata ka t'jenë tsiturë.

Të lumë lipisiaret, se ata ka t'gjejën lipisi.

Të lumë ata çë kanë zëmbërën e pastërë, se ata ka t'shohiën Perëndin.

Të lumë pakjësorët, se ata ka t' thriten bij të Perëndis.

Të lumë ata çë janë të përzënë për dërejtësin, se isht e 'tiria rregjëria e kjielliavet.

Të lumë jini ju kur ju shajën e kur ju përzënë, e kur ju thonë çëdo fiale të liga me të rreme paut meje.

Gëzonij e bëni hare, se e madhe dot jetë rroga juaj te kjiellia.

Të lumë ata çë ti ke sgledhurë e çë ke priturë mirë, o Zot e kuitimi i 'tire brez pas brezi.

(Me tingullin i gjashtët)

O Ti çë je i Zoti i shpirteravet e i kurmëvet * e çë te dora jote mban gjellën t'ënë * Ti çë je ngushullimi i atireve çë janë ndë helme, * jipi prëhie te

vendi i të dërejtëvet * shërbëtorëvet t'atë çë ndërruan jetë.

Krishti ju dhëfshit prëhie në vent të gjallëvet * e sbillëshit diert e Parraisit * e ju pritëshit mirë te rregjëria e 'tijë, e ju dhëfshit ndëjesen e mëkatëvet çë bët te këjo jetë o të dashurit e Krishtit.

Lëvdi pastë...

Lëvdi Atij çë ngë ka të zënë fill, çë ngë ka të ler, çë ngë ka njeri përpara vetëhes s' 'Tij * Atin u proskjinis çë lindi Birin * Birin u lëvdonj çë u le nga Ati, me Atin e me Birin u këndonj * të bashkëshkëlkjiemin Shpirtin Shejt.

Nani...

Si të buron sisa, o Virgjëreshë? * Si tagjis Ti Atë çë jep të ngrënë gjithë jetës? * si e pa Ai çë mënd' e buroi ujët nga guri për popullin e 'tij i vdekur etiet * ashtu si sgledhiëm te të Shkruamet shejte.

Letra e shën Palit

Shpirtërat e 'tire ka t'jesiën në të mira, o Zot.

Tij ka te thërres, o Zot, Perëndia jim. Letra e shën Palit (I Thessal. IV. 12-18).

Vëllezër, Ngë dua të jini të pa-diturë mbi ata çë u kjëlluan: mos vuhij ne lip, ashtu si t' jerët çë ngë kanë shpresën.

Përçë në na kemi besë se Isuthi vdikj e u ngjall, kështu edhe Perëndia dot marrënjë të ndëjemitë me 'të per anë të Isuthit.

Përse, mbi fialën, e t' in' Zoti ju thomi: se na çë jemi gjallë, lënë për të ardhurit e t'in'Zoti ngë ka arrëjëm atireve çë janë kjëlluarë.

Pse in'Zot mbas urdhërit e zërit e arkëngjejit me trumbetën e Perëndis ka sdripet nga kjiellia e ata çë vdikjën mbë Krishtin ka t'ngjallen të parët.

Andai na te gjallët çë kemi mbeturë ka t'jemi rrëmbierë mbi miekullatë me ata të përpiekiëm t'ën' Zonë në erë e kështu dot jemi gjithëmonë bashkë me t'ën' Zonë.

Përandai ngushullonij njeri me t' jetërin me këto fialë.

Alliluia.

Të lumë ata çë ti ke sgledhur e çë ke pritur mirë; kat rrinë te shpia jote.

E kujtimi i 'tire brez pas brezi.

E sa të jemi bër të mirë të gjegjemi Vangjejin shejt t'i lutemi t'in'Zoti Perëndis t'ënë.

Lipisi, lipisi, lipisi, o i madh'in'Zot.

Dieja! Ngremi shtuara te gjegjemi Vangjejin Shejt. Pakjen patshit ju te gjithe.

Edhe shpirti i jit.

Si shkruan Shen Jani piese e Vangjejit shejt.

Levdi, i madh'in'Zot, patshe levdi.

Vumi 're, gjegjemi.

Vangjeji shejt

In'Zot tha Judhenjëvet çë u kishën kjasur: Me të vërtetë me të vërtetë ju thom se kush gjegjet fialën t'ime edhe ka besë tek Ai çë më ka dërguar, ka gjellën e pasosme edhe ngë bie në gjikim; po nga mortëja ka shkuar te gjella. Me të vërtetë me të vërtetë u ju thom, se ka të vinjë hera e isht këjo nani, çë të vdekurit ka të gjegjen zë-

PKSH

rin e t'Birit t'Perëndis e ata ç'e gjegjen kat rrojën. Përse si Ati ka gjellë në vetëhe, kështu i dha edhe të Birit të ket gjellë në vetëhë. E i dha zotëri atij të bëj ligjë, pse isht Bir njeriu. Mos famasij për këtë, përse ka të vinjë një herë çë gjithë ata çë janë te varret kat gjegjen zërin e t'Birit t'Perëndis e kat dajën ata cë bën të mirë ndë të ngjallur gjellie; por ata çë bën të kekj, ndë të ngjallur gjikimi.

U ngë mëndë ngak u të bënj gjë; ashtu si gjegjem u gjikonj; e gjikimi i jim isht i dreit, pse u ngë kërkonj vullimin t'im, po vullimin e Tatës cë më dërgoi.

(Jan. VI. 35-39)

In'Zot i tha Judhenjëvet çë kishën pasur besë tek Ai: U jam buka e gjellës; ai çë vien tek U ngë dot ket uri e kush ka besë tek U ngë dot ket kurr etë.

Po ju thash se më kini par e ngë kini besë.

Gjithe ate çë me jep Ati kat vinjë tek U; e U ngë dot ndsier jashta atë çë vien tek U.

Se U u sdripa nga kjiellia jo sa t' bënjë atë çë dua U po atë çë do Ai çë më ka dërguar.

E ki isht vullimi i Atit çë më ka dërguar, sa U të mos sbier gjë nga gjithe atë çë me ka dhënë, po t'e ngjallë tek e sprasmia ditë.

(Jan. V. 17-24)

In'Zot i tha Judhenjëvet çë ju kishën kjasur: Ati jim njera m'nani punon, edhe u punonj.

E perandai më shumë Judhenjët kërkojën t'e vrisiën, se jo vetëm ngë ruaj të shtunien, po edhe se Perëndin e thërisëj Ati i tiji, tue u bër gjithënjë me Perëndin. Por Iisui u pergjegj e i tha atireve.

Me të vërtetë, me të vërtetë ju thom: i Biri ngë mëndë të bënjë gjë nga ai vet, në ngë pafshit t'e bënjë i Jati, pse atë cë bën Ai këtë gjithe-një e bën i Biri.

Përçë Ati e do mirë të Birin e i dëfton gjithë atë çë Ai bën e ka t'i dëftonje të bëma më të mëdha se këto, sa ju të famasij.

E si pran Ati sgjon të vdekurit e i jep gjellë kështu edhe Biri jep gjellë kuj do.

Se Ati ngë gjikon njeri, po gjithë gjikjin ja ka dhëne të Birit:

Sa gjithë të nderojen Birin ashtu si nderojen Atin. Kush ngë nderon Birin ngë nderon Atin çë e ka dërguarë.

Me të vertetë, me t'vertetë ju thom se kush gjegjet fialën t'ime edhe ka besë tek ai çë më ka dërguarë, ka gjellë të pasosme edhe ngë bie në gjikim, po nga mortëja ka shkuar te gjella.

Lëvdi, i madh'in'Zot, patshe lëvdi. Për shumë vietë, o Zot.

Patshe lipisi për ne, o Perëndi, për sa e madhe isht lipisia jote, na gjekj, të lutemi, patshe lipisi.

Të lutemi, i madh'in'Zot për Ipeshkupin t'ënë Josifin e për gjithë priftërin.

Të lutemi edhe për ata të lumë e të përmendëshim çë stisën këtë Klishë shejte e për gjithë prindërat e vëllezëritë t'anë çë flën varzuarë këtu e ku-do ndodhenë.

Pse Ti je Perendia i lipisis me njeriun çë do mirë, e na të japiëm lëvdi Tij, Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithë monë e për jetë të jetëvet. Amin.

Bashkë me Shpirtërat të drejtë të mbraruarë, prëj shpirtërat e shërbëtorëvet t'atë, o Shelbues, e ruaj ata te jeta e lume ç'isht pranë Teje, Ti çë do mirë njerëzin.

Te prëhia jote, o Zot, teku gjithë shejtërat t'atë prëhen, prëj edhe shpirtërat e shërbëtorëvet t'atë, se Ti vetëm je i pavdekëshim.

Lëvdi pastë...

Ti je Perendia ç'u sdripe te Pisa, e çë sglidhe dhëmbimet e të lidhurëvet; prëj Ti edhe shpirtërat e shërbëtorëvet t'atë, o Shelbues.

Nani...

E vetmia e kulluame dhe e pangarë Virgjëreshe, çë Perëndin paj t' Shpirtit Shejt linde, ndërmjeto sa të shpëtonen shpirtërat e shërbëtorëvet t'atë.

Kijna lipisi. o i madh'in'Zot. paj të madhes lipisis s'ate. na të lutemi. Ti

gjegjëna e kijna lipisi. Lipisi, o i madh' in'Zot.

Edhe të lutemi për prëhien e shpirtëravet e të ndëjemëvet shërbëtorë të Perëndis (aktsilët) e sa t'i ndëjenen atire gjithë ftesat të bëma tue dashur e pa dashur. Lipisi. o i madh'in'Zot.

Sa i madh' in' Zot, Perëndia jinë t'i japënjë vend shpirtëravet të atireve teku prëhen të dërejtitë. Lipisin e t'in' Zoti, rregjërin e kjielliavet e ndëjesen e mëkatëvet t' 'tjre nga Krishti i pavdekëshmi Rrekj e Perendia jine, lypmia. Ena, o i madh'in'Zot.

Lutemi t'in'Zoti. Lipisi, o i madh'in' Zot.

O Perendi i shpirtëravet e i gjithë kurmëvet, çë shkele mortien e munde e shtipe djallin e i dhe gjelle jetës s'ate, Ti, o i madh'in'Zot, jip prëhie shpirtëravet e te ndëjemëvet shërbëtore t'atë (aktsilët) në vend të dritës, në vend të gëzimit, në vend të dhrosis, teku ngë isht dhëmbim, lypë e psherëtim. Çedo mëkatë çë ata kanë bërë me të fola, me të bema, me tru, Ti çë je i mirë, o Perëndi, e çë do mirë njerëzin, ndëjeja.

Se Ti vetëm je i pa mëkatë, dërejtësia jote isht dërejtësi për gjithë monë e fiala jote isht e vërteta, Se Ti je ngjallia, gjella e prëhia e të ndëjemëvet shërbëtorë t'atë, o Krisht Perëndia jine e na Tij të faliëm lëvdi bashkë me Atin t'ënt të pazënë fill e bashkë me gjithëshjtim e të mirë e gjellëdhënës Shpirtin t'ënt nani e për herë e mbë jetë të jetëvet. Amin.

Jipi prëhien, o Zot, shpirtëravet të të vdekurëvet të krështerë orthodhoxë. Në vend shejt e ne horë të të dërejtëvet prit ata shpirtera, o Shelbues, e jipi prëhie.

Dituri! Bekona o Zot. Ju bekoftë Krishti, Perendia jine i vërtetë, nani e për gjithë monë për jetë të jetëvet. Amin.

Gjith'e shejte Mëma e t' in' Zoti, shpëto-na.

Tij më të nderoshme se Hjeruvimtë, e pa të përkrahur më të lëvdoshme se Serafimtë, çë pa fare u ndotur, të Lartën Fialë linde, vërteta Mëme t'Zotit, po madhërojëm na.

Lëvdi Tij, o Perëndia jinë, lëvdi Tij.

Lëvdi paste Ati...

Zoti Krisht i ngjallur së vdekurish i vërtet Perëndia jinë paj të Povirgjërës e shën Mëri e dëlira Mëmë e 'tij e paj të Apostojvet të lëvduare e embërshkëlkjierë e të Atëravet t'anë të ndershmë e theoforë, vufshit në vend të të dërejtëvet edhe shpirtërat e shërbëtorëvet t' 'Tij çë ngak na u ndajtën tue ndërruar jetë. I dhëfshit prëhie në gji të Abramit, nëmërofshit ndër të dërejtitë e neve na paçit lipisi, si i mirë e dashamirë. Amin.

Parkalesiëm për shpirtërat e mirë,
Çë te zjarri me pakje durojën
E çë përesiën ndër lotë me dëshirë
Te Parraisi të shkojën në gëzim.

Zoti Krisht, na të thomi për dita:
Jipi ndëjesën, Ti prëhien dhuroi;
Te ku mblen e pashuashme drita
Për gjithë monë ata klofshin të lumë.

Ata shpirtëra t'ën'Zonë dishirojën,
Perëndin ata thëresiën gjithë-herët,

Perëndin ata vetëm kerkojën
Te Parraisi do t'gjejën pushim.

Po sa riejën se ng'shohiën t'ën'Zonë!
Sa pshertime nga zëmbrat i dajën!
Nat'e ditë pa u lodhur po thonë:
Shuana, o Zot, këtë të math dishirim.

Gjëri e mikjë çë te jeta po rroni,
Thonë ata ndër mundimet e zjarrit.
Motra e vëllezër mos ju të harroni
Se na përesiëm ngak ju ngushullim.

Ngushullim e dhrosi ngak na përesiën,
Nga të krështerët, nga Klisha e
t'in'Zoti,
ngushullim e dhrosi ata përesiën
njer të ken të pasosmin trazhgim.

BKSH

Scuola Tipografica Salesiana - Palermo

BKSH

BKSH